#### b. Prcaktime

##### Siperfaqe perdorimi:

.Vendi ne te cilen do te ushtrohet veprimtaria per qellimin e ushimit te aktivitetit te saj.

. Rruge kalimi /E drejta e kalimit - .

#### Neni 1

##### Objekti i Kontrates

1.1 "Qiradhenesi" i jep me qira Subjektit " Omnix - Albania " Shpk, per perdorim siperfaqen prej 28.018 ha, e cila eshte ngastra pyjore Nr. 70abcd e ekonomise pyjore Rrotull, dhe eshte me keto kufizime dhe kordinata:

##### Kufizimet

Veri - Vazhdimi i ngastres pyjore nr. 70.

Jug - Ngastra pyjore nr.69.

Lindje - Kanali kullues dhe ne distance rruga auto per ne Drac

Perendim - Ngastra pyjore 70d , ranishtja e plazhit publik

##### Kordinatat

| KOORDINATA |         |           |
|------------|---------|-----------|
| Pika       | Y       | X         |
| 1          | 376,076 | 4,599,732 |
| 2          | 375,975 | 4,600,593 |
| 3          | 376,234 | 4,600,645 |
| 4          | 376,273 | 4,600,485 |
| 5          | 376,343 | 4,600,509 |
| 6          | 376,421 | 4,599,859 |
| 7          | 376,457 | 4,600,600 |
| 8          | 376,511 | 4,600,556 |



*Handwritten signatures and initials.*

*Handwritten signature.*



1.2. Përmirësimi i qëndrueshmërisë të territorit nëpërmjet:

- a. ruajtjes së përdorimit aktual të tij si pyll dhe funksioneve të përcaktuara në planin e mbareshtrimit.
- b. menaxhimit të qëndrueshmërisë dhe burimeve natyrore.
- c. kryerjes së ndërhyrjeve për rehabilitimin e biodiversitetit natyror.

1.3. Sigurimi i qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale të menaxhimit nëpërmjet përdorimit të territorit për qëllime rekreacioni. Për këtë respektohen kushtet e mëposhtme:

- a. Lejohet vendosja, pa u kufizuar vetëm në to, e objekteve si çadra, tenda diellore, si dhe vend parkime, sheshe pushimi të gjelberuara me stola druri, bulevard për shetitje dhe ndricim rrugor, sipërfaqe të argetimit dhe lojrave ujorë, shesh pushime të gjelberuara, ambiente sportive dhe pishina, ambiente permanente shërbimi.
- b. Objektet të vendosen në sipërfaqet djerr duke minimizuar dëmtimin e vegjetacionit ekzistues.

1.4 Qiradhenesi i jep gjithëashtu qeramarrësit sipërfaqen prej 28.018 ha për përdorim dhe sipërfaqen për rrugë kalimi -.

## Neni 2

### Qëllimi

2.1. Kjo kontratë ka për qëllim dhënie në përdorim të sipërfaqes së përcaktuar për mbareshtrimin e flores së eger dhe kultivimin e bimeve të ndryshme si dhe për qëllime pushimi argetimi (kënde lojërash, mjedise sportive çlodhese në nenin 1 të kësaj kontrate për ndërtim për qëllime pushimi dhe argetimi (kënde lojërash, mjedise sportive çlodhese), të lejes Nr. 1779/2 datë 1304.2011 të Ministrisë Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për dhënie në përdorim të një sipërfaqe prej 28.018 ha janë pjesë integrale të kësaj kontrate.



*[Handwritten signatures]*

*[Handwritten signature]*



### Neni 3

#### Afati i Kontrates

- 3.1. Kontrata e Qerases lidhet per nje afat 10 vjeçar duke filluar nga data 20.05. 2011 deri ne 20.05. 2021.
- 3.2 Gjashte (6) muaj para perfundimit te afatit te mesiperim , secila Pale ka te drejte te kerkoje shtyrjen e afatit te kontrates per te njejten periudhe.
- 3.3 Ne mungese te kesaj kerkese te Paleve, kontrata do te rinovohet automatikisht per te njejten periudhe dhe me te njejtat kushte.

### Neni 4

#### Vlera vjetore e qerases

Vlera vjetore e qerases eshte 2.590.810 leke per nje total 28.010 ha , e llogaritur sipas lidhjes 2, te VKM Nr.1064. Date 22.12.2010 "Per disa ndryshime ne VKM Nr. 391, date 21.06.2006 " Per percaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe kullotave ”.

#### Pagesa

| Nr    | Emertimi i sipërfaqes sipas qeverisjes | Ngastrat pyjore | Sipërfaqja ha | Tarifa lek/ha/vit | Leke/vit |
|-------|--|-----------------|---------------|-------------------|----------|
| 1     | Trungishte                             | 70ab            | 22            | 100000            | 2200000  |
| 2     | Cungishte                              | 70c             | 4             | 75000             | 300000   |
| 3     | Djerre                                 |                 |               |                   |          |
| 3     | Sipërfaqet inproduktive (dhe djerre)   | 70d             | 2.018         | 45000             | 90810    |
| Shuma |  |                 | 28.018        |                   | 2590810  |

### Neni 5

#### Pagesa dhe regjimi i saj

- 5.1 Pagesa e qerases do te behet çdo vit sipas kushteve te kesaj Kontrate.
- 5.2 Pagesa e pare do te behet brenda dhjete (10) diteve nga nenshkrimi i Kontrates nga Palet.



5.3 Çdo pagese tjeter e përvitshme do të bëhet me datën 10 janar të çdo viti.

5.4 Vlera e qerasesh është e pandryshueshme. Ajo do të ndryshojë vetëm nëse do të ketë ndryshime të aktit nënligjor VKM Nr.1064. Datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM Nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave".

5.5 Qiraja do paguhet në llogari bankare me nr. 0100000116, Raif. Bank për Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Durrës.

5.6 Në rast se qiramarresi nuk do të kryejë pagesën sipas kushteve të vendosura sa me sipër, Qiradhenesi pranon një kamat vonese prej 0.01% për çdo ditë vonese, por jo më shumë se 10% e vlerës së pagesës përkatëse. Për efekt të llogaritjes së kamatëve vonese do të konsiderohet data e përcaktuar në pikën 5.3 të kësaj kontrate.

#### Neni 6

#### TE DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHENESIT

6.1 Qiradhenesi merr përsipër dhe garanton qiramarresin që për sipërfaqen e përcaktuar në nenin 1 të kontratës, i krijon qiramarresit mundësinë që ta gëzojë dhe ta përdorë atë qetësisht ndaj pretendimeve pronësore të ngritura nga të tretët.

6.2 Qiradhenesi do të jetë përgjegjës për çdo taksë mbi pasurinë që është e pagueshme (në ngarkim) nga pronari, apo ndonjë taksë tjetër të ndryshme nga tatimi mbi të ardhurat. Nëse Qeveria Shqiptare do të miratojë ndonjë procedurë për të detyruar qiramarresin të veprojë si agjent në pagimin e taksave të tilla, qiramarresi në përputhje me ligjin do të zbrisë këto shuma nga qiraja që duhet të paguajë Qiradhenesi.

6.3 Qiradhenesi nuk përgjigjet për pretendime të tjera që, nuk kanë të bëjnë me objektin dhe qëllimin e kontratës.

6.4 Qiradhenesi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur qiramarresi nuk ka shlyer vlerën e qirases për vitin pasardhës, demton ose nuk mirëmban e përmirëson sipërfaqen e marrë në përdorim, nuk përmbush në mënyrë të dukshme detyrimet që rrjedhin nga kontrata dhe ato të përcaktuara në lejen Mjedisore, si dhe kur sipërfaqja e dhënë në përdorim duhet për interesa publike të miratuar nga KRT apo KRRTRSH.



*[Handwritten signatures]*

*[Handwritten signature]*



## Neni 7

### TE DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRESIT

7.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, "Qiramarresi" ka të drejte që: për të punësuarit e saj, agjentet, përfaqësuesit dhe çdo person tjetër që qiramarresi i konsideron të përshtatshëm, të ketë të drejtë të hyjë lirisht në pronën objekt të kësaj kontrate; të kryejë çdo veprim të cilin mund ta konsiderojë të nevojshëm ose të dobishëm gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij; të transportojë persona, mallra, paisje dhe materiale të tjera brenda sipërfaqes të marre me qira, të bëjë ndërtime të perkoheshme (belvedere bufc portative) si dhe punime të tjera të çdo natyre në përputhje me kërkesat e Lejes Mjedisore dhe të Lejes së miratuar për ushtrimin e aktivitetit të saj.

7.2 Qiramarresi do të kryejë me shpenzimet e veta, çdo punim mirëmbajtjeje që do t'i konsiderojë të nevojshme në sipërfaqen e marre në përdorim dhe në rrugën e kalimit.

7.3 Qiramarresi do të përdorë sipërfaqen dhe Rrugin e Kalimit me qëllim për të ushtruar aktivitetin e saj siç detajohet në lejet, licencën dhe vendimet perkatese të gjykatës.

7.4 Të mbrojtë dhe mirëadministrojë sipërfaqen pyjorë/kullosore në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9385 datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, të ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar.

7.5 Të lejojë dhe të shoqërojë punonjësit e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Durrës të ushtrojë kontrolle për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara në kontratë për sipërfaqen e fondit pyjor/kullosor të dhënë në përdorim.

7.6 Qiramarresi detyrohet të zbatojë çdo dispozitë ligjore që del e re ose ndryshim që u bëhet atyre ekzistuese për pyjet, kullotat dhe gjuetinë.

7.7 Për çdo shkelje të konstatuar në zbatim të pikave të mesipërme të kontratës, zbatohen kërkesat e nënve 37 dhe 38 të ligjit 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" të ndryshuar.

7.8 Qiramarresi nuk ka të drejtë të japë me nënqira dhe të lidhë nën kontraktime me subjekte të tjera apo, t'ia kalojë kontratën e lidhur një subjekti tjetër.



*[Handwritten signatures]*

*[Handwritten signature]*





## Neni 8

### DETYRIME TE PERBASHKETA TE PALEVE.

- 8.1 Ne rast se Qiradhenesi do te transferoje titullin e pronesise per siperfaqen e dhene ne perdorim ose ndonje pjese te rruges se kalimit. Qiramarresi ka te drejten e parablerjes.
- 8.2 Qiramarresi duhet te njoftoje Qiradhenesin nese Qiramarresi ka si synim te perdore te drejten e parablerjes ose jo, brenda pesembedhjete (15) diteve nga dita ne te cilen Qiramarresi ka marre njoftimin me shkrim.
- 8.3 Qiradhenesi nuk do te lejojte pale te tjera te perdorin siperfaqen e marre ne perdorim prej tij, apo paisje te tjera te ngjashme, ne pronen e marre me qira nga Qiramarresi apo ne afersi te saj, pa pelqimin paraprak te Qiramarresit.
- 8.4 Ne fund te periudhes se kesaj kontrate ose perfundimin e saj, Qiramarresi do te do te rehabilitoje siperfaqen per cdo demtim qe mund te jete shkaktuar gjate veprimtarise, dhe do ta dorezoje siperfaqen e marre, siç ishte ne gjendjen fillestare, pervec konsumimit fizik normal.
- 8.5 Te gjitha njoftimet dhe komunikimet midis Paleve do te behen me shkrim ne adresat:

Per Qiradhenesin - Drejtoria e Shebimit Pyjor Dures  
Per Qiramarresin - Subjekti "Omnix - Albania" Shpk,

## Neni 9

### FORCA MADHORE

- 9.1 Ne rast se ndonje nga Palet e kesaj Kontrate pengohet te permbushe te gjitha ose nje pjese te detyrimeve te saj te parashikuara ne kete Kontrate si pasoje e Forces Madhore, kjo Pale nuk do te jete pergjegjese per mospermbushjen e detyrimeve te saj gjate kohezgjatjes se Forces Madhore dhe per pasojat e shkaktuara dhe qe rrjedhin nga Forca Madhore.

*[Handwritten signatures]*



*[Handwritten signature]*



9.2 Pezullimi i ekzekutimit të kësaj Kontrate si pasojë e Forces Madhore do të kufizohet në periudhën e kohës gjatë së cilës do të vazhdojnë efektet e Forces Madhore.

## Neni 10

### ZGJIDHJA E KONTRATES

10.1 Kontrata zgjidhet me marreveshje midis paleve si dhe me mbarimin e afatit të zgjatjes së kontratës, datë 20.05.2021

10.2 Kontrata zgjidhet përpara mbarimit të saj vetëm për shkak të ndryshimit dhe mosrespektimit të kushteve kontraktore, të kërkesave të lejes mjedisore si dhe nëse sipërfaqja e dhënë në përdorim nga Qiramarresi, duhet për interes publik, të miratuar me vendim të KRT apo KRRTRSH.

### DISPOZITA E FUNDIT

Për çështje që nuk trajtohen në kontratën e mesipërme do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil që trajtojnë kontratën e qirase.

Mosmarreveshjet gjatë zbatimit të kësaj kontrate, zgjidhen me mirëkuptim të paleve : në të kundërt në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Çdo korigjimi i kontratës, pas nënshkrimit të saj, e bën atë të pavlefshme.

Kjo kontratë qiraje u formulua në tre kopje origjinale, nga të cilat një e merr Qiramarresi, një Drejtoria e Sherbimit Pyjor Durrës dhe një qëndron në arkivin e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.



*Handwritten signature or mark.*

*Handwritten signatures of the parties.*





Shefi i Sek. Menaxhimit  
Hysen Shkreli

*[Signature]*

Pergatiten  
Shefi i Sek. Finances  
Amarilda Beu

*[Signature]*

Juristi  
Alban Goga

*[Signature]*

**PALET:**

**QIRADHENESI**  
**DREJTORIA E SHERBIMIT PYJOR DURRES**


**QIRAMARRESI**  
**SUBJEKTI "OMNIX-ALBANIA" SHPK**

**DREJTORI**  
**ENYER MASHA**



**ADMINISTRATORI**  
**FADI MITRI**

*[Signature]*








**Shtojca si pjese integrale e kesaj Kontrate:**

- Shtojca 1.** Harta e koordinatave te miratuara per zonen 28 ha.
- Shtojca 2.** Plani urban dhe mjedisor i miratuar
- Shtojca 3.** Vendimi i KRTRSH ne 1. Dt 27.10.2009 per miratimin e lejes se ndertimit
- Shtojca 4.** Vendimi i KRTRSH ne 1. Dt 27.10.2009 per miratimin e studimit urbanistik
- Shtojca 5.** Ekstrati i QKR per kompanine OMNIX Albania
- Shtojca 6.** Certifikata e rregjistrimit te personit te tatueshem (NIPT) OMNIX Albania



*Handwritten signature*





ONNIX ALBANIA sh.p.k  
NIPIT: K 81527005 D  
TIRANE

Water Line



PER: MINISTRINE E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMET E UJRAVE  
FORM: "ONNIX ALBANIA" sh.p.k LALEZI BAY  
SH 1:2000

Total area: 28 Ha as per coordinates

| Pika | Y      | X       |
|------|--------|---------|
| 1    | 376076 | 4599732 |
| 2    | 376060 | 4600651 |
| 3    | 376127 | 4600700 |
| 4    | 376167 | 4600566 |
| 4/1  | 376235 | 4600599 |
| 5    | 376343 | 4600509 |
| 5/1  | 376324 | 4600502 |
| 6    | 376396 | 4599849 |
| 6/1  | 376445 | 4599874 |
| 6/2  | 376422 | 4599854 |
| 7    | 376457 | 4600600 |
| 8    | 376511 | 4600556 |





Annex 2



A2021053950194181629







A2021053950194181629

Shtojca 2





**"OMNIX ALBANIA" SH.P.K**  
**TIRANE**

# **PROJEKT**

**Per**

**Mbarështimin e flores se eger, kultivimin e bimeve te ndryshme dhe ushtrimin e veprimtarive sportive e turistike (Kende lojrash per femije, kamping).**

**Objekti "Gjiri i Lalzit" Drrac.**

**Ekonomia pyjore "Rrotull"**

**Ngastra nr.70.**

**Pergatiti**

**OMNIX ALBANIA" SH.P.K**

**ADMINISTRATOR**

**FADI MITRI**

**PROJEKTUES "DEJA" sh.p.k.**

**Inxh. Hazis PORJA**

**Firma private Imp Exp**

**"DEJA" Shpk**  
**MAT ALBANIA**

**Janar 2011**





## **PERMBAJTJA E PROJEKTIT**

Projekti i mbareshtimit te grumbullit pyjor dhe kultivimi i bimeve te ndryshme perbehet nga keto pjese:

- 1. Qëllimi i projektit.**
- 2. Objektivat e projektit.**
- 3. Përshkrimi i territorit.**
- 4. Treguesit identifikues kadastral te ngastrave dhe n/ngastrave**
- 5. Treguesit e vlerës për njësinë kadastrale te pyjeve**
- 6. Masat dhe mjetet për mbarështimin e florës se egër dhe kultivimin e bimëve te ndryshme**
- 7. Planifikimi i punimeve, preventivat dhe kostoja ekonomike**
- 8. Përmbledhëse e punimeve dhe investimeve qe do te kryhen**
- 9. Pjese te vizatuara(harta, skica punimesh, ngrehinash) etj.**

### **1. QELLIMI I PROJEKTIT**

Hartimi i këtij projekti mbareshtimi, për kryerjen e këtyre punimeve, ka për qëllim qe nëpërmjet masave biologjike dhe hidroteknike qe do te ndërmerren, te krijohen kushte te përshtatshme për zhvillimin optimal te bimësisë pyjore, ruajtjen e qendrueshmerise se grumbullit, për te kthyer pamjen pejsazhiste dhe argetuese si dhe krijimin e kushteve për strehimin e faunës.

Synimi i këtij projekti, nëpërmjet masave komplekse qe parashikon te ndërmerren, ka për qëllim mbrojtjen dhe rehabilitimin e këtij territori dhe kthimin e resurseve natyrore te humbura.

Për rehabilitim te kësaj zone do te përdoret futja e bimësisë pyjore te përshtatshme për te mbrojtur dhe vlerësuar këto terrene. Zbukurimi i plazhit dhe përmirësimi i klimës se tij. Krijimi i një rezerve drusore e jo drusore (rrëshire, fistike, etj) ne zonen ku kjo mungon dhe popullsia do te behet me e dendur.

Veshja bimore do te shërbeje për mbrojtjen nga erozioni i erës duke krijuar kushte optimale per pushim dhe argetim, për strehim dhe zhvillim te faunës se egër, kryesisht shpendëve te ujit, te cilët dikur kane qene banore te kësaj zone. Ndërhyrjet biologjike janë te domosdoshme për stabilizimin e këtyre sipërfaqeve, shtimin e qendrueshmerise dhe multifunksionalitetit te grumbullit, duke filluar me mbjelljen e kulturave pyjore



...shumë, por ato kushtojnë edhe më shumë se paraqiten. Llojet pyjore stabilizuese dhe mbrojtëse do të jenë kryesisht ato që i përshtaten kushteve klimatike-tokësore, si: frasher, ilqe, verri, shëlg, pishat mesdhetare, bimësia drusore autoktone që ndodhet në këtë zonë, të cilat shërbejnë për përmirësimin e strukturës së tokës, filtrimin e ajrit, strehimin e faunës së egër, etj. Masat e karakterit hidroteknik, të cilat kërkojnë investime kapitale, do të ndikojnë në krijimin e kushteve të përshtatshme për instalimin dhe zhvillimin e bimësisë pyjore, pa prishur pamjen natyrale, pejsazhiste të objektit.

Ky studim për rehabilitimin e territorit, me ndërhyrje biologjike e hidroteknike ka vlerë për hapjen e një perspektive të re për zhvillimin e kësaj zone, si dhe krijon koncepte të reja se kjo zonë mund të rehabilitohet me një punë të studiuar, se shteti punon dhe do të punojë për përmirësimin e kushteve për shfrytëzimin e vlerave turistike të kësaj zone si pasuri kombëtare.

## 2.OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Objektivat e projektit të sipërpërmendur janë:

1. Mbarështimi i florës së egër për qëllim të popullimit të zonës ku do të zhvillojë në perspektivë zhvillimin e aktiviteteve kulturore e sportive.
2. Pyllëzimin e terreneve të përshtatshme me kultura pyjore që favorizojnë instalimin dhe mbrojtjen e sipërfaqes së tokës, rritjen e qendrueshmerisë dhe multifunksionalitetit të grumbullit dhe përmirësimin e faunës
3. Për krijimin e kushteve të përshtatshme për qarkullim dhe arëtimin e vizitoreve.
4. Organizimin dhe sistemimin e infrastrukturës për lehtësimin e kalimit të vizitoreve në gjithë territorin e sipërfaqes që do të merret në përdorim.
5. Ushtrimin e veprimtarive sportive dhe argëtuese.

Sipërfaqja që do të merret në përdorim është sipërfaqe me pyje dhe bimësi pyjore, ku me masat që do të merren, do të përmirësojë rrënjësisht strukturën, qendrueshmerinë e saj duke instaluar bimësi pyjore, me krijimin e disa blloqeve me kultura të larta dhe shkurrore për strehimin kafshëve dhe shpendëve të egra (strehim dhe baze ushqimore). Sipërfaqja e kërkuar për mbarështimin e florës dhe faunës do të rrethohet me materiale të lehta drusore dhe tel gabion dhe gjithë aksesoret e nevojshëm për mbarështimin e gjahut do të jenë sipas kërkesave dhe ligjeve të mbrojtjes dhe zhvillimit të ekonomisë pyjore dhe kullësore. Aktiviteti i mësipërm për shtimin e faunës së egër, punimet që do të kryhen, mirëmbajtja dhe trajtimi me masat e nevojshme do t'i mbështesim me projekte të mirëfillta të hartuar nga specialiste kompetente të kësaj fushe. Objekti kryesor i mbarështimit do të jetë dhe në perspektivë, në vartësi të kushteve të reja që do të krijohen, mendojmë të zhvillojmë gjahun me larmishmëri me lloje shpendësh të ujë të kultivuara



## 1. Te dhëna te përgjithshme

Ne mbështetje të nenit 19 të ligjit nr. 9385, datë 04/05/2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar me kompetencën për miratimin e projekteve të studimit për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullosor e ka Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Objekti i marrë në konsideratë bën pjesë në Zonën Mosdhetare të Larit (Lauretum) të bimësisë që ka përparësi zhvillimin e turizmit.

Sipërfaqja e përgjithshme e marrë për studim është 16.2 ha.

Fondi pyjor ka pësuar ndryshime në pakësim si rezultat i dëmtimit dhe shfrytëzimit të pyjeve duke kaluar në fond me bimësi pyjore.

Si rezultat i veprimit të fenomeneve erozive të detit në objekt ka ndodhur pakësimi i sipërfaqes, si dhe mbathja e detit me ledh nga depozitimet.

Vitet e fundit janë kryer disa punime të konsiderueshme në drejtim të mirëmbajtjes dhe funksionalitetit të kësaj zone.

Efektiviteti i këtyre masave tekniko- organizative ka ndikuar ndjeshëm në stabilizimin e gjendjes si dhe të ndryshimit të konceptit se kjo zonë do të qëndrojë me këtë funksion të rëndësishëm shoqëror dhe se do të vazhdojë të zhvillohet si e tillë.

## 2. Pozicioni gjeografik

Parcela nr. 70 ndodhet në ekonominë pyjore "Rrotull", gjeografikisht ndodhet në veri-perëndim të rrethit të Durrësit, rreth 20 km larg qendrës së Bashkisë Durrës. Nga ana administrative, administrohet nga DSH Pyjor Durrës.

### 2.1 Kufijtë e objektit:

Sipërfaqja e objektit të marrë në studim ndodhet brenda këtyre kufijve natyrale:

Veri: Pyll dhe ruga auto

Lindje: Toke buke

Jug: Pyll

Perëndim: Formimi i Ri Litoral (Deti Adriatik)

( Shih planimetrinë në shkallën 1: 10 000 )

### 2.2 Sipërfaqja e përgjithshme e objektit të marrë për studim është 16.2 ha.

Sipërfaqja me bimësi pyjore do të stimulohet që të shtohet si në ruge natyrale ashtu dhe duke e kultivuar me lloje të përshtatshme për strukturimin optimal dhe ushqimin e strehimin gjahut.

Ka mjaft vende të ngritura, me toke lymore (ledh), në formë njollash të cilat do të shfrytëzohen për kultivimin e bimëve të ndryshme barishtore për prodhim baze ushqimore për gjahun që mund të mbarështohen në perspektivë.

## 3. Rruget e komunikacionit:

Objekti "Ekonomia pyjore Rrotull", në brendësi të tij nuk ka asnjë ruge kryesore automobilistike, por në veri të tij, vjen ruga auto nacionale e rikonstruktuar vitet e fundit



... me shprehur shume qartësimin për shfrytëzimin dhe përmirësimin e resurseve natyrore shume te favorshme te këtij ambienti bregdetar. Gjithashtu mungon dhe rrjeti rugor këmbësor ne brendësi te tij. Ne periudhe thatësire (Vere -fillim vjeshte), mund te futen mjete bulqësore ose makina tip fuoristrade, duke e përshkuar objektin tej për tej. Distanca nga qyteti Tiranës, me rruge auto është 43 km, nga qyteti Durrësit 25 km

#### **4. Kushtet Stacionare**

##### **4.1 Orografia.**

Terreni është i sheshte me pak ondulacione vende -vende (ka mbingritje), ose depresione ne pjese te ndryshme.

Lartësia mbi nivelin e detit varjon nga 2 deri ne 7 m.

##### **4.2 Kundrejtimi.**

Meqenëse forma e terrenit është sheshte, kemi te bëjmë me kundrejtimin zenit

##### **4.3 Hidrografia.**

Ky objekt nuk ka rrjet hidrografik te zhvilluar ne brendësi te tij.

Punimet qe do te bëhen parashikojnë ndërtimin e 1 pusi te tille për krijimin kushteve te përshtatshme për gjahun dhe përdorimin e tij për nevojat e aktivitetit qe do te zhvillohet. Ne përfundim ndodhet një brez rere 50-100 gjerësi -formim i Ri Litoral ne detin Adriatik. Nga pikëpamja hidrologjike zona ka disa horizonte ujëmbajtëse, te cilat nga poshtë lart mund t'i radhisim:

Horizonti i poshtëm shkon deri ne thellësinë 30-40 m (sipas pusit artezian qe ndodhet ne këtë territor), me depozitime rëre kokërr imët, kokërr mesme deri ne zhavorr.

##### **4.4 Ndërtimi gjeologjik.**

Territori ne fjale i përket depozitimeve kuaternare te cilat si baze shërbejnë depozitimet me te vjetra.

Trashësia e depozitimeve te shkrifta lëkundet nga disa metra deri ne 40-60cm

Ndërsa depozitimet e shkrifta kane shtresëzim horizontal.

Ne marrëdhëniet me bazën këto vendosen me diskordance këndore duke mos lënë mënjane edhe atë stratigrafike.

Shkëmbinjtë e formacioneve baze karakterizohen nga formacione konglomerati.

##### **4.5 Toka**

Toka përfaqësohet nga depozitime lymore subargjile, suberanore, e rëra te imta lymore, me përmbajtje lendesh bimore te dekompozuar.

Ne përgjithësi është ranore me përmbajtje subargjile e subrere, dhe ne thellësi kalojnë ne rëre.

Lloji i tokës ne objekt është si rezultat i depozitimeve te reja te detit, pa strukture ose pjeserisht shume pak strukture, me prezence te theksuar te lendeve ushqyese deri ne thellësi, dhe me humus te ceket ne ato pjese ku sipërfaqja është e veshur me bimësi pyjore.

Toka e objektit ndahet:



Ne baze te këtyre grupimeve do te përcaktohet mënyra e përgatitjes se tokës dhe lloji qe do te kultivohet.

Toka ne përgjithësi klasifikohet ne toka te varfra me pjellori te ulet.

Ne këto toka nuk mund te flitet për strukture, mbasi mungojnë elementet e dukshëm qe te behet klasifikimi i tyre.

#### Pershkrimi morfologjik i horizonteve te tokes

| Horizonti | Thellesia | Pershkrimi i horizontit  |
|-----------|-----------|--|
| A         | 0-15      | Gati pa strukture, pershkoet nga sistemet rrenjore te bimesise.  |
| AB        | 15-35     | Gati pa strukture, pershkoet pjeserisht nga rrenjet e bimesise barishtore dhe me shume nga ato te drureve e shkurreve. |

## 4.6. Klima

Zona qe studihet bën pjese ne zonën klimatike Mesdhetare Fushore, nen zona fushore qendrore, e cila karakterizohet nga mbizotërim i masave ajrore kontinentale gjate gjysmës se ftohte te vitit, ndërsa gjate gjysmës se ngrohte te vitit mbizotërojnë masat ajrore detare.

### 4.6.1 Temperatura.

Kjo ndikon direkt ne sasinë e vlagës gjate periudhës se verës si dhe ne krijimin e një shtrese ajri shume te nxehte 10-15 cm mbi sipërfaqen e tokës duke nxehur token e cila sjell tharjen e bimëve.

Temperatura mesatare shumëvjeçare për këtë objekt jepet ne te dhënat e tre stacioneve midis te cilave ndodhet, konkretisht si me poshtë:

Te dhënat e tabelës janë përpunuar posaçërisht për rrethin e Durrësit duke përdorur gradientin termik.

Zgjatja mesatare e diellit ne ore: 2612

Te dhënat e mëposhtme na shërbejnë për te gjykuar për zhvillimin e bimësisë pyjore, zgjedhjen e llojeve, kohen dhe tekniken e mbjelljes, masat mbrojtëse ndaj këtyre faktorëve kufizues, mundësinë për efektivitet e punimeve qe parashikohen te kryhen etj. Temperatura mesatare e janarit lëviz nga 6.5-7.5 °C, ndërsa minimumet absolute te zakonshme janë -3 deri - 5 °C, ne dimra te ftohte -7 deri -9°C, e ralle deri ne -10 e -13 °C

Periudha e vegjetacionit (me temperature mesatare  $\geq 10^{\circ}\text{C}$ ), përfshin intervalin e kohës Mars - Nëntor (dekada e pare mars, dekada e pare dhjetor, ndërsa ditët me temperature minimale  $\leq 10^{\circ}\text{C}$ , kapin numrin 15-30 dit, te përqendruara kryesisht ne periudhën e dimrit.

Ne jetën e bimësisë ndikojnë vetëm muajt me temperature te larte, për shkak te thatësisë qe krijohet, ndërsa muajt e dimrit ne këtë zone janë te bute dhe nuk shkaktojnë dëme .

Pra dhe vëmendja me e madhe i duhet kushtuar muajve te verës Maj-Shtator.



Temperatura mesatare mujore e ajrit për një periudhe 45 vjeçare (e reduktuar) është:

| Stacioni | M u a j t |     |      |      |      |      |      |      |      |      |      |     | Mes. vjetore | E ngrohje IV-IX | Stinet   |         |           |          |
|----------|-----------|-----|------|------|------|------|------|------|------|------|------|-----|--------------|-----------------|----------|---------|-----------|----------|
|          | I         | II  | III  | IV   | V    | VI   | VII  | VIII | IX   | X    | XI   | XII |              |                 | D XII-II | P III-V | V VI-VIII | Vj IX-XI |
| DR       | 7.8       | 8.8 | 11.2 | 14.9 | 18.8 | 22.2 | 25.1 | 25.4 | 22.4 | 18.2 | 13.9 | 9.9 | 16.6         | 21.5            | 3.8      | 5.9     | 24.2      | 18.2     |

Temperaturat e dobishme (mbi 10 °C)

| Temperatura mesatare mbi 10° c |                 |             |
|--------------------------------|-----------------|-------------|
| Data e fillimit                | Data e mbarimit | Ditezgjatja |
| 2/III                          | 14/XII          | 287         |
|                                |                 |             |

#### 4.6.2 Reshjet.

Reshjet kane një ndikim te madh ne zhvillimin e bimësisë.

Sasia e reshjeve arrin 1500-1700 mm ne vit, me numër ditësh me reshje 85-100 dite.

Lartesia mesatare shumevjeçare e rreshjeve ne m/m

| Stacioni | M u a j t |       |       |       |      |      |      |      |      |       |       |       | Shuma  | E ftohte X-III | E ngrohje IV-IX | Stinet   |         |           |          |
|----------|-----------|-------|-------|-------|------|------|------|------|------|-------|-------|-------|--------|----------------|-----------------|----------|---------|-----------|----------|
|          | I         | II    | III   | IV    | V    | VI   | VII  | VIII | IX   | X     | XI    | XII   |        |                |                 | D XII-II | P III-V | V VI-VIII | Vj IX-XI |
| DR       | 17.9      | 145.2 | 135.5 | 104.0 | 85.2 | 68.1 | 32.9 | 46.3 | 89.9 | 181.2 | 200.3 | 176.6 | 1433.5 | 8006.4         | 427.1           | 488.4    | 324.7   | 148.8     | 472.4    |

Kjo mungese e reshjeve ne këtë periudhe, nuk është aq kufizuese, sepse është prania e detit qe nuk lejon kombinimin e saj me lagështinë relative ajrore nen 30%.

#### 4.7 Ererat

Erërat mbizotëruese, ne periudhën e dimrit, janë ato qe fryjnë nga jug-lindja , ndërsa ne vere ato nga veri perëndimi. Erërat influencojnë sidomos ne tharjen, deformimin ose ngadalësimin ne rritjen e bimëve. Ne objektin e marre ne studim vërehen erëra ne drejtim VL,VP, JP, P dhe lindore, nga te cilat janë me te rastësishme ato JP dhe J qe fryjnë gjate verës dhe ato VL dhe L qe fryjnë gjate dimrit.

Efekt kufizues për këtë objekt bëjnë erërat qe fryjnë nga drejtimi JP dhe P, te cilat sjellin ujë te pulverizur qe përmban kripe, duke ndikuar negativisht ne tharjen e bimësisë pyjore.

Nga tabelat e mësipërme shihet se shpejtësia me e madhe e erës është ne muajt Tetor, Dhjetor deri ne Mars.

Erërat e verës shkaktojnë transpirationin me te madh duke i thare ose përzhitur bimët, ndërsa ato te dimrit sjellin dëmtime mekanike (shkulje, thyerje).



Vegetacioni i tokës kane ererat qe tryjnë nga deti, mbasi ato krahas thatësire se madhe influencojnë dhe ne lëvizjen e rrëave dhe sjellin kripe ne brendësi te objektit duke dëmtuar bimësinë pyjore. Ky tregues duhet pasur parasysh ne zgjedhjen e llojeve qe i rezistojnë dëmtimeve mekanike dhe ajrit qe përmban kripe. Nga studimi i faktorëve klimatike e sidomos temperaturës, reshjeve dhe erërave, rezultojnë se për te instaluar bimësi pyjore duhen mare një seri masash kundër thatësirës se tepërt dhe lagështisë se madhe. Për këtë duhen zgjedhur lloje qe i rezistojnë thatësirës, temperaturave te larta, te tokës dhe amplitudave te larta ditore sikurse janë llojet halore bregdetare, ilqja, valanidhi dhe shkurret mesdhetare. Për te evituar efektin e ngricave te vonshme, verën e thate dhe amplitudat e medha te ditëve te verës, mbjelljet e kulturave pyjore duhen bere gjate vjeshtës, nga muaji Nëntor deri ne fund te Dhjetorit, me përjashtim te mbjelljeve te pishës se bute me fare qe duhet bere ne dekadën e pare te muajit shtator, para fillimit te shirave te para te vjeshtës. Agroteknika e punimit te tokës duhet te jete e tille qe te evitohet asfiksionin e bimësisë nga përmbajtjet dhe tharjen e saj gjate verës. Për këtë krahas punimit te tokës me sope, dhe me gropa, duhet bere dhe mbulimi i qafës se fidanëve me materiale vegetative. Për te evituar influencën negative te erërave ndaj bimësisë dhe gjahut jo shtegtar, duhet ngritur një brez me bimësi te larte ne te katër anët e objektit.

**Shpejtësia mesatare e erës ne m/sek**

| Stacioni | M U A J T |     |     |     |     |     |     |      |     |     |     |     | Mes. |
|----------|-----------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|------|-----|-----|-----|-----|------|
|          | I         | II  | III | IV  | V   | VI  | VII | VIII | IX  | X   | XI  | XII |      |
| Durrës   | 3.5       | 3.6 | 3.4 | 1.9 | 2.2 | 2.0 | 2.1 | 2.3  | 2.6 | 3.5 | 1.7 | 4.3 | 2.8  |

#### 4.8 Treguesit klimatik te thatësirës

Këta tregues paraqesin ne mënyre sintetike klimën prandaj po marrim ne konsiderate treguesit e me poshtëm për objektin qe kemi ne studim:

##### 4.8.1 Treguesi i thatësirës De Martonit

###### 4.8.1.1. Koeficienti i bilancit te ujit te Seljanovit.

Shpreh raportin midis shumes se reshjeve qe bien ne një periudhe te caktuar dhe shumes se temperaturës te se njëjtës periudhe pjesëtuar me 10.

Ky raport kur është i barabarte me 1 bima është e siguruar, kurse me te < 0.5 bima ndërpret zhvillimin

###### 4.8.1.2 Treguesi i Gaussen

"Muajt e thatësirës", rezultojnë te paktën 2 muaj thatësirë

$$4.8.1.3 \text{ Intensiteti vegjetativ } i = \frac{100 * \text{shumujor}}{T \text{ max} * \text{amp.ditore}}$$



Nga pikëpamja e vegjetacionit, objekti bën pjese ne zonën fitoklimatike te shkurreve mesdhetare(Lauretum), nenzona fitoklimatike e shkurreve mesdhetare.

Ngastra 70/c është me forme përdorimi pyll cungishte me funksion mbrojtës. Grumbulli është po thuaj i degraduar.

Nga faktorët qe përmendem me lart, bimësia natyrale qe takohet është e paket dhe po thuaj e degraduar. Nga flora barishtore me tepër takohen: qumështore (Euforbia paralias), jonxhe deti (medikago marina), rrodhja (xanthium strumarium), bari i majasellit (Teukrium Polium), grua (Inula viskoza), salicornia herbacea, salicornia fructicoza, xunktha (J. Acutus dhe J. effusu), shavari (Typha latifolia), thuepula (lotus corniculatus), tymus spp, menishte (cistum salvifolia), verbascum phomoloides, bellis perenis, geranium, asparagu, etj.

Bimesia pyjore eshte e paket dhe kryesisht perfaqesohet nga pisha e bute dhe disa shkurre.

Nga pikëpamja e rendësis për ekonominë e gjahut, rendësi te veçante kane barishtet e llojeve: Xunkthat (J. acutus, dhe J. effusus), salicornia herbacea, s. fructicosa. Shkurret e llojeve: Marina (Tamarix Africana), ferra (Rubus umifolius), verehen ralle shqope, krifshe, ilqe, Flora e sipërfaqeve ligatore përbëhet prej florës se ujit te ëmbël si: Chora fragilis dhe Leuna trisalcai, te cilat zënë një vend te preferuar për patat e egra. Nga faktorët qe përmendëm me lart bimësia natyrale pyjore është e paket: marine (Tamarix parviflora) e ralle, disa shkurre te familjes bishtajore, si dhe ka filluar instalimi natyral i disa ekzemplareve bimësie pyjore te zonës buferike: vidhi, rrënja etj, kryesisht ne pjesët me te ngritura te objektit ne zonën veri perëndimore.

Ne pjesët te drenuara është tërfili, jonxhe deti (medicago marina).

Ngastra nr 70/a eshte forme perdorimi pyll trungshte lloji pisha e bute, me funksion mbrojtës. Grumbulli eshte mesatar deri i mire me perspektive te mire zhvillimi.

Bimesia natyrale eshte e mire, ne zhvillim te kenaqshem, verehet instalim filizerie shume moshare, nenpylli i ralle me ilqe, krifshe, shqope, ferrmane, ka filluar shtimi i bimesise barishtore me te njejtat lloje si ne ng 70/c.

Po keshtu dhe ne ng 70/b e 70/c verehet instalimi ne menyre natyrore ne ane te masivit dhe ne brendesi i pishes se bute dhe llojeve te tjera shkurrore dhe barishtore, vlen te theksohet se ky fenomen eshte bere me i dukshem keto kohet e fundit mbas gjetjes se nje menyre me te mire, te mbrojtjes me strikte te ketij grumbulli.

Sipas kërkesave te kafshëve dhe shpendëve te egra dhe ne përputhje me konditat stacionare te objektit, sikurse e përmendëm me sipër duhet te shtojmë këto lloje drurësh dhe shkurre pyjore si pishat bregdetare, frasher fletngushte, dafine, ilqe, rrenje, verri etj.

Për veç kësaj duhen marre ne konsiderate dhe kultura te tjera te cilat mund te mbillen ne brendësi te objektit ne forme njollash.

## 6. Punimet te kryera.

Punime te kryera deri tani ne ketë objekt nuk ka pasur dhe as kane qene planifikuar, pervec nje pastrim te mbeturinave dhe sistemimit e ruajtjes me te mire te ketij grumbulli. Prandaj për fillimin e këtij aktiviteti puna duhet filluar me sistemimin e territorit. Persa i përket punimeve biologjike rezultatet kane qene te kënaqshme, por kjo eksperience duhet te shërboje për te fituar rezultate, për te krijuar grupe, tufa, ose blloqe me lloje qe rezistojnë kushteve te kripëzimit. Duke përfutur eksperiencën e pasur ne këtë vend, behet e mundshme qe te krijojmë një flore te përshtatshme pyjore dhe barishtore për strehimin e kafshëve dhe shpendëve te egra



Sipërfaqja që propozohet të jepet në përdorim është në pronësi shtetërore dhe administrohet nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Durrës.





#### 4.TREGUESIT IDENTIFIKUES KADASTRAL TE NGASTRAVE DHE NENGASTRAVE

##### a. Identifikimi kadastral, përdorimi i territorit, qeverisja, funksioni.

Ne pasqyrën e mëposhtme po japin te dhënat e ngastrës që është studiuar te jepet ne përdorim 1 ha për qëllimin e përcaktuar me lart.

| T01 identifikimi kadastral |             |        |        |        |       |                   |                  |                |            |                        |                         |           |                       |
|----------------------------|-------------|--------|--------|--------|-------|-------------------|------------------|----------------|------------|------------------------|-------------------------|-----------|-----------------------|
| ID njësi kadastrale        | ID pronësor | Qëllim | Rreth  | Komuna | Fshat | Emërtimi ekonomik | Ngastri ekonomik | Forma e pronës | Proan      | Emërtimi administrativ | Përdorim                | Sipërfaqe | Referencë dokumentare |
| DR06 0 070a                | DR06 0 070a | Durrës | Durrës | Durrës | Ishëm | x                 | EP Rrotull 0     | 70 a           | shtetërore | DSHP Durrës            | Durrës pyll             | 10.75     | Pl.mb.v.1984          |
| DR06 0 070b                | DR06 0 070b | Durrës | Durrës | Durrës | Ishëm | x                 | EP Rrotull 0     | 70 b           | shtetërore | DSHP Durrës            | Durrës djet             | 17.00     | Pl.mb.v.1984          |
| DR06 0 070c                | DR06 0 070c | Durrës | Durrës | Durrës | Ishëm | x                 | EP Rrotull 0     | 70 c           | shtetërore | DSHP Durrës            | Durrës pyll             | 18.00     | Pl.mb.v.1984          |
| DR06 0 070d                | DR06 0 070d | Durrës | Durrës | Durrës | Ishëm | x                 | EP Rrotull 0     | 70 d           | shtetërore | DSHP Durrës            | Durrës inprodur (tjere) | 25.50     | Pl.mb.v.1984          |

| T02a karakteristika të grumbullit pyllor |             |                 |                   |                    |                              |            |                   |      |  |
|--|-------------|-----------------|-------------------|--------------------|------------------------------|------------|-------------------|------|--|
| ID njësi kadastrale                      | ID pronësor | Funksion pyllor | Funksion ekonomik | Forma e qeverisjes | Tel i pyllit                 | Përzierja  | Shtetë e natyrale | Ko   |  |
| DR06 0 070a                              | DR06 0 070a | mbrojtës        | mbrojtja e tokës  | frangjshite        | pisha mesdhetare te thjeshta | i thjeshtë | artificiale       | 0.70 |  |
| DR06 0 070c                              | DR06 0 070c | mbrojtës        | mbrojtja e tokës  | cungjshite         | plep në ranishte             | te përzier | natyrale          | 0.60 |  |



b. Përshkrimi i vegjetacionit

Treguesit kryesorë të grumbullit pyllor, të dhënat dendrometrike

**T04 - Pyllët treguesit sipas llojeve**

| ID_MJK        | Kodi | % e llojit | Lloji            | Forma e<br>përdorimit | Forma e<br>përdorimit | K0   | K1   | Lm,<br>m3 | Lok,<br>m3 | Dz,<br>m3 | Pv,<br>m3/m |
|---------------|------|------------|------------------|-----------------------|-----------------------|------|------|-----------|------------|-----------|-------------|
| DR14 0 070a N |      | 100.00%    | preha mesdhetare | trungjshite           | hetorë                | 4.00 | 3.00 | 460.00    | 125.30     | 230.00    | 5.60        |
| DR14 0 070c N |      | 20.00%     | pep              | trungjshite           | hetorë                | 2.00 | 4.00 | 0.00      | 0.30       | 0.00      | 0.00        |
| DR14 0 070c N |      | 70.00%     | verri            | trungjshite           | hetorë                | 2.00 | 4.00 | 0.00      | 0.30       | 25.00     | 0.30        |
| DR14 0 070c N |      | 10.00%     | trashëtar        | trungjshite           | hetorë                | 2.00 | 4.00 | 0.00      | 0.00       | 0.00      | 0.00        |

5. TREGUESIT E VLERES PER NJESINE KADASTRALE TE PYJEVE

Nga llogaritja e vlerës së pyjeve dhe kullotave sipas një metodeke baze të miratuar, rezultojnë se vlera e pyjeve dhe kullotave për njësinë kadastrale jepet në pasqyrën e mëposhtme.

Vlera e pyjeve për Komunën Ishëm

| Përdorimi i territorit | Forma e qeverimit | Sip_ha   | Vlera transaksionit, Lek/ha | Vlera e transaksionit, Lek | Lp m3     | Çmimi Lp, Lek/m3 | Vlera e LP, Lek | Dz m3     | Çmimi Dz, Lek/m3 | Vlera e Dz, Lek | Vlera/ha, pyjet |
|------------------------|-------------------|----------|-----------------------------|----------------------------|-----------|------------------|-----------------|-----------|------------------|-----------------|-----------------|
| pyll                   | trungjshite       | 18.25    | 10000                       | 182,500.00                 | 0.00      | 2000             | 0.00            | 342.00    | 160              | 54,720.00       | 12,998.36       |
| pyll                   | cungjshite        | 2,060.31 | 10000                       | 20,603,120.00              | 5,368.00  | 1800             | 10,562,400.00   | 54,652.10 | 160              | 8,744,334.00    | 19,370.78       |
| pyll                   | abkarre           | 2,316.51 | 10000                       | 23,165,080.00              | 35.00     | 0                | 0.00            | 19,031.10 | 160              | 3,044,976.00    | 11,314.47       |
| pyll                   | trungjshite       | 703.79   | 10000                       | 7,037,900.00               | 30,190.00 | 2000             | 60,380,000.00   | 23,181.00 | 160              | 3,708,960.00    | 100,804.57      |



## **D.MASA I DHE MJETET PER MBARESHTIMIN E FLORES SE EGER DHE KULTIVIMIN E BIMEVE TE NDRYSHME.**

### **1. Masa sivoteknike**

Këto masa janë te rëndësishme, mbasi trajtimi i florës dhe i bimësisë pyjore ka rëndësi te veçante për zhvillimin dhe mbrojtjen llojeve që do të mbarështohen. Këto masa sivoteknike, mundësojnë përmirësimin e gjendjes ekzistuese të florës së objektit duke futur kultura pyjore që do të shërbejnë për krijimin e kushteve për pushim, argetim dhe strehimit të gjahut. Kulturat pyjore që do të përdoren për pyllëzimin këtij objekti do të jenë pishat mesdhetare, kryesisht pisha e bule, ilqja, rrenja, trasheri fletngushte etj. si dhe shkurret apo dhe lloje të tjera të vlefshme që ndodhen në zonën periferike të këtij objekti.

Nder masat me te rëndësishme te karakterit silvikulturor janë ndërhyrjet me pyllëzime, me lloje të përshtatshme, për krijimin grumbujve pyjore, të cilët do të shërbejnë e për krijimin e një peisazhi tërheqës për vizitorët dhe strehimin e gjahut, krijimi disa bankinave me dhe të sjelle për mbjelljen bimëve dekorative.

Nisur nga gjendja ekzistuese e florës së objektit si dhe masave që do të merren nëpërmjet punimeve të ndryshme, po japim të dhëna mbi natyrën e pyllit dhe mbi këtë baze do të kihet parasysh për kryerjen e punimeve që duhet t'i përshtaten zhvillimit të florës dhe faunës së egër që do të propozohet të zhvillohet në këtë objekt.

### **7.PLANIFIKIMI I PUNIMEVE, PREVENTIVAT DHE KOSTOJA EKONOMIKE**

#### **Planifikimi i punimeve dhe investimeve**

Planifikimi i punimeve do të bëhet duke u mbështetur në vëllimin e punimeve të përlogaritura për gjithë objektin.

Në preventiva jepet kostoja të punimeve për njësi.

#### **Preventivat e punimeve**

Janë hartuar kryesisht preventivat e punimeve për zërat kryesore të ngritjes së aktivitetit siç janë:

- Kryerje pyllëzimi artificial me pisha mesdhetare në një sipërfaqe prej 16.2 ha
- Ndërtim i një kulle vrojtimi
- Rrethim i një sipërfaqe prej 16.2 ha me tel gabion e shtylla betoni
- Ndërtimi i disa ngrehinave mbi nivelin e tokës me material drusor për ta përdorur për qëllimin e përdorimit të kësaj sipërfaqeje.
- Ndertimi i rugicave me pllake betoni per kembesoret
- Vendosja e cesmave te ujit per pushuesit.
- Ndertimi ose vendosja e kendeve te vegjel per lojra per femije

Punime për kultivim bime dekorative. Për këto është hartuar tabela përmbledhëse e koston se punimeve sipas zërave si dhe vendosjes të mjeteve të tjera ndihmese.



## Preventiv

( 1 PYLLEZIME me llojin Pishe Bregdetare me skemen 3x2 me 1700 fid/ha)

**Objekti :** Shtegu i frasherit(Gjiri i Lalzit)

**Ekonomia pyjore :** Rrotull

**Ngastra nr.70**

**Siperfaqia :** 16.2 ha.

**Skema e mbjelljes :** ( 3x2 ) m.

| Shenja<br>e<br>Manualit | Pershkrimi i punimeve                             | Njesia<br>matjes | Volumi<br>punes | Norma<br>ditore | Dite<br>pune | Paga<br>ditore | Shuma<br>leke |
|-------------------------|---|------------------|-----------------|-----------------|--------------|----------------|---------------|
| 222-1                   | Pergatitje piketash per piketim<br>objekti        | cope             | 1700            | 800             | 2.12         | 954            | 2027          |
| 222-3                   | Piketim objekti, 2 punetore                       | cope             | 1700            | 400             | 4.25         | 1908           | 8108          |
| 223-7                   | Hapje gropash 40x40x40 cm ne<br>toke mes.te forte | cope             | 1700            | 45              | 37.7         | 954            | 36036         |
